

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Komuna e Podujevës**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr ¹ i prokurimit	615-24-10786-5-2-1
------------------------------	--------------------

Sa i përket tenderit për Ngritja e infrastrukturës së turizimit

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ELITE PREMIUM BAU SHPK & EING COM SHPK

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Balloç

(Adresa)

Balloç

(Vendi)

(Kodi postar)

043807306

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Endrit Ymeri

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

elitepremiumbaushpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

20.12.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe mulla)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontrate 14.10.2024
Hapja e ofertave 04.11.2024
Njoftimi mbi vendimine AK – 04.12.2024
Kerkesa për ri shqyrtim 10.12.2024
Vendimi i AK-se – refuzimi 11.12.2024

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo

☐

Hapja e ofertave 04.11.2024

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Grupi i OE-ve ankues ELITE PREMIUM BAU SHPK & EING COM SHPK me datën 10.12.2024, bazuar në nenin 108/A të LPP-se, ka parashtruar kërkesë për ri shqyrtim të vendimit të AK-se, propozimit për anulimin e kontratës gjegjësisht arsytimit të eliminimit të kompanisë sonë ku janë prezantuar prova dëshmi dhe fakte me të cilat është konfirmuar përgjegjshmëria e ofertës sonë, megjithatë AK – Komuna e Podujevës, përsëri konsumon shkelje ligjore dhe refuzon kërkesën tonë si të pa baze pavarësisht faktit se asnjërin nga pretendimet tona ankimore nuk i trajton.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji me nr. 04/L-042, për Prokurim Publik

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi
Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës
Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve
Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 108/A – Zgjidhja preliminare e mosmarreveshjeve.

Rregullorja me nr. 001/2022, për Prokurim Publik

Neni 38 Sqarimi i Tenderëve
Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Udhëzuesi me nr. 001/2023, për Prokurim Publik

Neni 10 sqarimi i tenderit

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Te nderuar,

Grupi i Operatoreve Ekonomik ankues: ELITE PREMIUM BAU SHPK & EING COM SHPK, fillimisht me datën 04.12.2024, kane pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se – Komuna e Podujeves, ku është rekomanduar për anulim e kësaj procedure, perderisa sipas letres standarde te datës 04.12.2024, grupi yne i OE-ve tentohet te eliminohet ne kundershtim me dispozitat ligjore ne fuqi dhe ne kundershtim me provat dhe faktet e bashkangjitura ne oferte.

Ndaj grupit te OE-ve ankues si arsyetim i eliminimit AK Komuna e Podujeves gjegjesisht zyra e Prokurimit ka potencuar dhe na ka eliminuar per kete arsye:

B42 - Letër standarde për [tenderuesin] [kandidatin] e eliminuar³

04.12.2024.2024

Podujevë Rr.Nuhi Gashi

Group i OE: Premium Bau SH.P.K;EING COM SH.P.K.-Podujeve

Nr. i prokurimit:	615	2	4	1	0	7	8	6	5	2	1
-------------------	-----	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Titulli: _Ngritja e infrastruktures se turizmit

I/e nderuar(a) [Z/Znj]]

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim “LPP “ [Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në [dosjen e tenderit] [dokumentet parakualifikuese]. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim: [Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

[Tenderi juaj është refuzuar] për këto arsye :

Grup i Operatoreve Ekonomik Elite Premium Bau SH.P.K.; EING COM SH.P.K. Aneksi 7 i ngarkuara nga OE nuk i perbush kushtet, pasi qe OE nuk e ka ngarku Aenkin 7 me ndryshime sipas DT.

Te njejtin arsyetim ne si OE e kemi kontestuar ne procedure paraprake kemi prezantu prova dhe dëshmi konkrete përmes te cilave konfirmohet se asnjera nga arsyet e eliminimit te potencuara ne leter standarde nuk qendrojne, megjithate AK këto prova gjegjesisht pretendimet tona ankimoe fare nuk i trajton dhe refuzon kerkesen si te pa bazuar, prandaj ne kuptim te nenit 109 te LPP-se ne afatine parapare paraqesim këtë:

ANKESE

Argumenti 1

AK- Komuna e Podujeves na ka eliminuar ne menyre te pa drejte edhe pse i kemi ofruar fakte dhe dëshmi qe arsyeja e eliminimit nuk qëndron dhe nuk përkon me faktet, pra ne jemi eliminuar per arsyen e lartëcekur se kinse nuk e kemi ngarkuar Aneksin 7 ashtu siq eshte kërkuar ne DT, dhe ne me poshtë po ju deshmojm se Aneksi 7 i kërkuar nga AK eshte i njëjti me ate te cilin ne e kemi dorzuar:

Aneksi 7 i prezantuar dhe i kërkuar nga AK ne DT:

Numri i Prokurimit: 615-10786-521– Titulli: Ngritja e infrastruktures se turizmit

Aneksi 7

(Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten e dëshmitë e kërkuara ne FTD)

Nr.	Lloji i mekanizmit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia e ofertuar nga OE
1	Eskavator min 40 ton	2	
2	Eskavator 20-30 ton	2	
3	Eskavator me lugë para dhe mbrapa	2	
4	Kamion kipper deri 20t pesha bartëse	2	
5	Kamion apo cistern për pastrimin e rrugëve (me A test vëllimi)	1	
6	Kamion kipper me kran pesha bartëse 2 - 4t	1	
7	Grejder 2-6ton	1	
8	Buldozer 19-20 ton	1	
9	Cilinder max 1 ton	1	
10	Cilinder 7-8 ton	1	
11	Damper me peshë min 17ton	3	
12	Rrethoje për sigurimin e punishtes min m'	200	

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Kurse ky me poshtë është Aneksi 7 i prezantuar nga ana jone si OE:

Numri i Prokurimit: 615-10786-521– Titulli: Ngritja e infrastruktures se turizmit

Aneksi 7

(Ky Aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkëngjiten e dëshmitë e kërkuara ne FTD)

Nr.	Lloji i mekanizmit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia e ofertuar nga OE
1	Eskavator min 40 ton	2	2
2	Eskavator 20-30 ton	2	2
3	Eskavator me lugë para dhe mbrapa	2	2
4	Kamion kipper deri 20t pesha bartëse	2	2
5	Kamion apo cistern për pastrimin e rrugëve (me A test vëllimi)	1	1
6	Kamion kipper me kran pesha bartëse 2 - 4t	1	1
7	Grejder 2-6ton	1	1
8	Buldozer 19-20 ton	1	1
9	Cilinder max 1 ton	1	1
10	Cilinder 7-8 ton	1	1
11	Damper me peshë min 17ton	3	3
12	Rrethoje për sigurimin e punishtes min m²	200	200

Nënshkrimi i Operatorit Ekonomik _____

Vula _____



Pra siq shihet aneksi ne dosje te tenderit eshte i njejte me aneksin te cilin ne si OE e kemi prezantuar.

Siq shihet nga faktet e lartëprezantuara ne si OE jemi eliminuar në mënyr të pa drejtë sepse ne e kemi prezantuar Aneksin 7 ashtu siq është kërkuar ne dosje te tenderit:

<p>Operatori Ekonomik duhet të posedoj mjete, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit. Në rastë të marrjes me qira duhet të ofroj marrveshje në emër të këtij projekti</p>	<p>Pajisjet dhe mekanizmi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 7 të DT</p>
--	---

Si perfundim provat dhe dëshmitë e prezantuara si me larte tregojne se neve si grup i OE-ve pjesemarres ne këtë procedur te prokurimit jemi eliminuar ne mënyrë te kunderligjeshme dhe komisioni vleresues i ofertave me rastin e eliminimit te kompanis sonë ka shkelur si tërësi ne nin 59 te LPP-se dhe ne vecanti paragrafin 1, ku kjarre potencohet:

*“Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. **Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës...**”.*

Arsyetimi i eleminit te ofertës sonë si ne leter standarde te datës 04.12.2024, ndaj ofertës sonë konsumon edhe shkelje ligjore nga neni 52.3, lidhur me nenin 56.3 te LPP-se ku shprehimisht percaktohet:

*“Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, **nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit**”.*

Prandaj ne si operator ekonomik ankues, bazuar ne provat dhe deshmit e prezantuara si me sipër, kërkojmë nga OSHP, dhe zyrtaret përgjegjës te saje, qe si fillim te autorizojne ekspert shqyrtues te pa aneshem objektiv dhe njohes te mire te dispozitave te LPP-se ashtu siç percaktohet me nenint 113 dhe 114 te LPP-se dhe ti trajtoi te gjitha pretendimet tona ankimoe ne atë mënyrë qe paneli shqyrtues te nxjerre këtë:

V E N D I M

- I. Te aprovohet** ne tërësi si e bazuar ankesa e OE “ELITE PREMIUM BAU SHPK & EING COM SHPK
- II. Te anulohet** njoftimi mbi vendimin e AK-se i datës 04.12.2024, si i kunderligjeshem;
- III. Te kualifikohet** si e pergjegjeshme oferta e OE-ve Ankues: ELITE PREMIUM BAU SHPK & EING COM SHPK
- IV. Te obligohet AK – Komuna e Podujeves** qe këtë procedure te prokurimit ta kthej ne **ri-vlereim** dhe

V. Te lejohet kthimi i mjeteve te deponuara ne emer te ankeses.

Grupi i OE-ve ankues **ELITE PREMIUM BAU SHPK & EING COM SHPK** për këtë procedur te prokurimit do ti ndermerr te gjitha masat ligjore meqe posedon te gjitha provat dëshmitë dhe faktet përmes te cilave konfirmohet pa pergjegjesia zyrtare, keqperdorimi dhe tentativa për abuzim me para publike ne prokurim publik.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet amteriale janë te konsiderueshme dhe për te njejtat ne si kompani me patjeter pas perfundimit te teresishem te ketije procesi ne rast demeve tjera do te kërkojmë qe te kompanzohemi për te gjitha demet e shkaktuara te cilat kapin vlere te larte monetare dhe morale.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.